



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

Tezat e masterit për diskutim publik të miratuara nga Departamenti i Pedagogjisë

Me datë: 07.09.2022

ERBLINA ZABELI

Tema: Përshtypjet e mësimdhënësve për faktorët që ndikojnë në kënaqësinë në punë

Komisioni:

Prof. Ass. Ardita Devolli, mentore

Prof. Asoc. Vlora Sylaj, kryetare

Prof. Ass. Teuta Danuza, anëtare

ABSTRAKTI

Kënaqësia në punë përcaktohet si një përgjigje emocionale, efektive që rrjedh në procesin e punës. Kënaqësia në punë konsiderohet si një fenomen universal dhe koncept shumëdimensional që përfshin shumë burime që punonjësit perceptojnë për punën e tyre. Lënia anash e kënaqësisë së punës së mësimdhënësit e vë në rrezik efikasitetin. Prandaj, kënaqësia në punë është një komponentë e rëndësishme për të rritur efektivitetin në punën e mësimdhënësit dhe është e rëndësishme njohja e faktorëve dhe nivelit të tyre. Këto fakte e bëjnë gjithëmonë të rëndësishëm hulumtimin. Qëllimi i hulumtimit ishte për të studiuar, analizuar dhe eksploruar përshtypjet e mësimdhënësve për faktorët që ndikojnë në kënaqësinë e tyre në punë dhe jam përcaktuar për hierarkinë e katër faktorëve të studiuar. Hulumtimi është realizuar me casjen cilësore (kualitative) përmes së cilës janë studiuar përshtypjet e mësimdhënësve për faktorët që ndikojnë në kënaqësinë në punë në vecanti: klima e shkollës, udhëheqja e shkollës, marrëdhënia/bashkëpunimi kolegjial dhe kompensimi / paga. Në hulumtim janë të përfshirë 12 mësimdhënës, si mostër e qëllimshme. Për të adresuar pyetjet hulumtuese, kam përdorur intervista gjysmë të strukturuar të cilat përmbajnë shtatë pyetje. Analiza e të dhënave të këtij studimi është bërë përmes analizës tematike. Së pari kam bërë identifikimin e temave kryesore, pastaj janë identifikuar nëntemat dhe kam përshkruar përshtypjet relevante të respondentëve. Nga rezultatet e këtij studimi janë identifikuar faktorët që ndikojnë në kënaqësinë në punë, kam përcaktuar cili nga faktorët e studiuar ka ndikim më të madh në kënaqësinë në punë të mësimdhënësve kosovarë dhe masat që duhet të ndërmerren udhëheqësit e shkollës për të rritur nivelin e kënaqësisë në punë të mësimdhënësve. Hulumtimi tregoi se, mësimdhënësit e konsiderojnë komponentë të rëndësishme kënaqësinë në punë, si faktor i rëndësishëm për efikasitet dhe rezultate të mira në punë. Nga katër faktorët e studiuar, udhëheqja e shkollës dhe kompensimi/paga janë faktorë dominantë

Fjalët kyçe: faktorë ndikues, kënaqësi në punë, klimë e shkollës, kompensim, marrëdhënie me kolegë.

LUMNIJE HYSENI

Tema: Mësimdhënia dhe të nxëniet e Biologjisë së klasës së nëntë dhe kërkesat e Kornizes së Kurrikulës së Kosovës

Komisioni:

Prof. Asoc. Ruzhdi Kuqi, kryetar

Prof. Ass. Arlinda Beka, anëtare

Prof. Asoc. Zeqir Veselaj, mentor

ABSTRAKTI

Kurrikula e Kosovës synon që qytetarët e Kosovës të ballafaqohen me sfidat e shekullit XXI dhe të gjenerojnë dije të reja konkurruese në mënyrë aktive për tregun global të punës. Hulumtimi im në këtë drejtim është që sfidat që më janë paraqitur gjatë mësimdhënies së lëndës së biologjisë të trajtohen më gjerësisht me profesorin mentor, nxënësit, mësimdhënësit dhe autorët e tekstit. Ky hulumtim ka për qëllim shqyrtimin dhe analizimin e librit të Biologjisë së klasës së nëntë të SHFMU, gjegjësisht se sa ky libër është adekuat për këtë nivel shkollor. Po ashtu përmes pyetjeve të parashtruara hulumtuese do të shqyrtohet se sa është e domodoshme të bëhet ndonjë ndryshim në këtë tekst shkollor. Rezultatet e dalura nga hulumtimi janë se shumica e nxënësve kanë arritur nivel të kënaqshëm të njohurive, ky material nxënësve iu është dukur më i vështirë se sa ai i klasëve paraprahe. Nga analiza e të dhënave me mësimdhënësit e lëndës së biologjisë së klasës së IX-të del se: materia e këtij teksti është adekuat mirëpo duhet të thjeshtësohet pasi që shpeshhere po është e nevojshme të hulumtohet në internet për njësitë mësimore që po trajtohen, ngecja në të nxëniet e këtij teksti nga ana e nxënësve po vjen si pasojë e mos realizimit të të gjitha ushtrimeve që i parasheh ky tekst, të rritet numri i fondit të orëve të biologjisë dhe shumica e mësimdhënësve rekomandojnë ribotim të tekstit. Ndërsa autorët e tekstit deklarojnë se materiali është hartuar konform moshës së fëmijëve dhe se i plotëson ky tekst kërkesat e kurrikules ekzistuese, termet që hasen në këtë tekst vështirë memorizohen nga ana e nxënësve mirëpo janë të pakët, materiali në përgjithësi nuk është i vështirë veçse varet nga mësimdhënësit se si e elaborojnë këtë tekst. Në këtë drejtim janë nxjerrur konkludime konkrete.

Fjalët kyçe: *Biologjia, teksti mësimor, kurrikula, mësimdhënia, mësimnxënia.*

BAHRIJE HASANI

Tema: *Aplikimi i metodave bashkëkohore në mësimdhënien e gjuhës shqipe në shkollat fillore të mesme të ulëta (kl.I-V) në komunën e Mitrovicës*

Komisioni

1. Prof. asoc. dr. Naser Zabeli- kryetar
2. Prof. asoc. dr. Xhavit Beqiri- anëtar
3. Prof. dr. Naser Pajaziti-mentor

ABSTRAKTI

Ky hulumtim është hulumtim kuantitativ. Punimi ka për qëllim që të trajtojë hollësisht zbatimin e metodave bashkëkohore në mësimdhënien e gjuhës shqipe duke treguar se a e ndihmojnë dhe lehtësojnë procesin e mësimdhënies, në cilat zona shihet përdorimi më i madh i tyre dhe a vërehen dallime mes moshës dhe përvojës së mësimdhënësve. Metoda është rrugë apo mënyrë me të cilën drejtohem përgjatë zhvillimit të detyrave dhe aktiviteteve punuese. Përdorimi i metodave bashkëkohore në mësimdhënien e gjuhës shqipe ka efekt pozitiv në të nxëniet e qëndrueshëm të nxënësve. Popullata e këtij hulumtimi përfshinë të gjithë mësimdhënësit e shkollave të mesme të ulëta në Komunën e Mitrovicës. Të dhënat statistikore për numrin e shkollave dhe numrin e mësimdhënësve janë nga burimet zyrtare, përkatësisht nga MASHT “Statistikat e Arsimit në Kosovë 2021”. Pra popullata e këtij hulumtimi përbëhet nga 762 mësimdhënës (ASK, 2021). Mostra është zgjedhur në mënyrë të rastësishme është mostër sistematike. Dhjetë përqind e mësimdhënësve është mostër e hulumtimit – 76 mësimdhënës (pjesëmarrës). Njëzet përqind e shkollave janë pjesëmarrëse në hulumtim - 8 shkolla. Hulumtimi u realizua përmes një pyetësi i cili do t’i masë qëndrimet e mësimdhënësve në lidhje me zbatimin e metodave bashkëkohore në mësimdhënien e gjuhës shqipe. Të dhënat saiore u analizuan përmes analizave statistikore nëpërmjet paketës statistikore SPSS. Nga ky hulumtim u nxorën përfundime se përdorimi i metodave bashkëkohore në mësimdhënien e gjuhës shqipe e lehtësojnë mësimdhënien dhe mësimnxënien, përdorimi i duhur i tyre ndikon në suksesin e nxënësve dhe në motivimin e tyre për të nxënë.

Fjalët kyçe: *metodë, metodologji bashkëkohore, mësimdhënie, gjuhë shqipe.*

GRANIT ÇEKU

Tema: Ndikimi i praktikës në zhvillimin profesional të nxënësve të shkollave profesionale

Komisioni:

1. Prof. Ass. Arlinda Beka-mentore
2. Prof. Ass. Florent Bunjaku-kryetar
3. Prof. Ass. Vjollca Ahmedi-anëtare

Abstrakti

Arsimi profesional luan rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të shtetit. Përgatitja e të rinjve për tregun e punës, kërkon një bashkëpunim të ngushtë me shkollat dhe bizneset. Praktika profesionale është baza e zhvillimit profesional të punëtorëve të ardhshëm. Qëllimi i këtij hulumtimi është që të nxjerrë në pah ndikimin që praktika profesionale ka në përgatitjen dhe ngritjen profesionale të nxënësve, për tregun e punës. Ky punim është dizajnuar duke u bazuar në këto pyetje kërkimore: -Si organizohet praktika profesionale për modulet përkatëse në shkollat profesionale në vend? Sa ndikon praktika profesionale në përgatitjen dhe ngritjen profesionale të nxënësve për tregun e punës? Në cilat fusha praktika profesionale i ndihmon më së shumti nxënësit për përgatitjen e tyre për tregun e punës? Si vlerësohen nxënësit gjatë praktikës profesionale dhe çfarë roli ka vlerësimi tek nxënësit?

Për realizimin e këtij punimi është përdorur metodologji e kombinuar (sasiore dhe cilësore). Përmes pyetësorëve janë anketuar nxënësit e shkollave profesionale dhe përmes intervistave janë përfshirë udhëheqësit e shkollave profesionale, mësimitdhënësit mbikqyrës të praktikës si dhe përfaqësuesit e bizneseve, të cilët janë përgjegjës për organizimin dhe mbarëvajtjen e praktikës së nxënësve në kompani. Të dhënat e metodës sasiore janë përpunuar me SPSS, ndërsa të dhënat cilësore janë përpunuar përmes analizave tematike.

Populacioni i këtij studimi janë: udhëheqësit e shkollave, mësimitdhënësit e praktikës, nxënësit dhe përfaqësuesit e bizneseve të cilët janë përgjegjës për praktikën e nxënësve në kompani. Përzgjedhja e mostrës ka qenë e qëllimshme. Pjesëmarrësit në këtë hulumtim janë 5 drejtorë të shkollave: Sh.M.L.T. “Shaban Spahija” - Pejë, Sh.M.L.M. “Shkolla e Mesme e Mjekësisë” - Pejë, Sh.M.L.E. “Ali Hadri” - Pejë, I.A.A.P. “Euro School” - Pejë, Sh.M.L.T. “Tafil Kasumaj” - Deçan, 25 mësimitdhënësit të shkollave, 50 nxënës të shkollave dhe 25 pjesëtarë të bizneseve.

Fjalët kyçe: *Shkollat profesionale, praktika, zhvillimi profesional, arsimi profesional.*

